	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 1
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
Dioksid karboni (i ftohtë)		Zëvendëson : 0 / 0 / 0
		ALB-LCO2-018B



2.2 : Gaz jo i djegshëm jo toksik.

Kujdes



Përgjegjësi i shpërndarjes

Messer Albagaz sh.p.k.
 Autostrada Tiranë-Durrës km 4,5, Tirana, Albania
 Tel:+35548200696-Fax:+35548200697
info@messer.al-www.messer.al

1 Elementet identifikues të substancës ose përzierjes dhe shoqërisë/ndërmarrjes

Identifikuesi i produktit

Emri tregtar : Dioksid karboni (i ftohtë)

Skeda Nr : ALB-LCO2-018B

Emërtimi kimik : Dioksid karboni (i ftohtë)

N. CAS :000124-38-9

N. EC :204-696-9

N. i substancës :---

Formula kimike : CO2

Numri i regjistrimit: : Treguar në listën e Shtojcës IV / V ; e përjashtuar nga detyrimi për regjistrim.

Përdorimi : Përdorimi industrial dhe profesional. Bëni një analizë rreziku para përdorimit.

Identifikimi i shoqërisë : Messer Albagaz
 Autostrada Tiranë-Durrës km 4,5,
 Tirana, Albania

Numri telefonik i thirrjes urgjente : Messer Albagaz +355 48 200 696

2 Tregimi i rreziqeve


Klasifikimi i substancës ose përzierjes

Klasa e rrezikut dhe kodi i kategorisë së Rregullores CE 1272/2008 (CLP)

• **Rreziqet fizike** : Gaz nën presion – Gaz likuid i ftohtë - Kujdes (H281)

Klasifikimi 67/548/CE o 1999/45/CE : Jo i përfshirë në Shtojcën VI.
 Jo i klasifikuar si preparat i rrezikshëm.
 Asnjë etiketë CE e kërkuar.

Informacione për tu treguar në etiketë

	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 2
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
Dioksid karboni (i ftohtë)		ALB-LCO2-018B

2 Tregimi i rreziqeve /...

Etiketimi i rregullores CE
1272/2008 (CLP)

• Figurat e rrezikut



• Figurat e rrezikut
• Paralajmërim
• Tregime të rrezikut

: Kujdes
: H281 : Përmban gaz të ftohtë; mund të provokojë djegie ose plagosje kriogjenike.

• Këshilla kujdesi

- Parandalimi

: P282 : Përdorni doreza termike/mburoja/mbroni sytë.

- Reaksioni

: P336+P315 : Shkrini pjesët e ngrira duke përdorur ujë të ngrohtë. Mos e fshini pjesën e prekur. Konsultoni menjëherë një mjek.

- Ruajtja

: P403 : Të ruhet në një vend të ajrosur mirë.

Etiketimi 67/548/CE o 1999/45/CE

Simbole

: Asnjë.

Fraza R

: Asnjë.

Fraza S

: Asnjë.

Rreziqe të tjera

Rreziqe të tjera : Në përqëndrime të larta mund të provokojë asfiksi.

3 Përbërja/informacione mbi ingredientët

Substanca/Preparati : Substanca.

Emri i përbërësit	Përbajtja	N. CAS	N. EC	N. i substancës	Shënim	Klasifikimi
Dioksid karboni (i ftohtë)	100	124-38-9	204-696-9	-----	Shënim 1	Pres. Gaz (H281)

Nuk përmban produkte të tjera dhe/ose papastërti që ndikojnë në klasifikimin e produktit.

* 1: Treguar në listën e Shtojcës IV / V ; e përjashtuar nga detyrimi për regjistrim.

* 2: Skadenca e regjistrimit jo e kaluar. Testi i përfunduar i Frazës-R, shih kapitullin 16

4 Masat e ndihmës së shpejtë

Masat e ndihmës së shpejtë

- Inhalacioni

: Në përqëndrime të larta mund të shkaktojë asfiksi. Simptomat mund të përfshijnë humbje të lëvizshmërisë dhe/ose vetëdijës. Viktimat mund ta kuptojnë asfiksionin. Përqëndrimet e ulëta të CO2 shkaktojnë rritje të frekuencës së frymëmarrjes dhe dhimbje koke.

Spostoni viktimën në zonën jo të ndotur duke vënë autorespiratorin. Mbajeni pacientin të shtrirë dhe nxehtë. Thërrisni një mjek. Vazhdoni me frymëmarrjen artificiale në rast të ndalimit të frymëmarrjes.


- Kontakti me lëkurën dhe me sytë

: Lani menjëherë sytë me ujë për jo më pak se 15 minuta. Në rast djegie nga ngrirja spërkatni me ujë për së paku 15 minuta.

Aplikoni një garzë sterile. Kërkoni asistencë mjekësore.

- Gëlltitja

: Përmes ekspozimit pak e mundshme.

	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 3
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
Dioksid karboni (i ftohtë)		ALB-LCO2-018B

5 Masat antizjarr

Rreziqe specifike	: Ekspozimi në flakë mund të shkaktojë prishje ose shpëthim të kontejnerit.
Produktet e rrezikshme të djegies	: Asnjë.
Mjetet e shuarjes	
- Mjetet e përdorshme të shuarjes	: Mund të përdoren të gjitha mjetet e shuarjes të njohura.
Metoda specifike	: Nëse është e mundur ndalni rrjedhjen e produktit. Largohuni nga kontejneri dhe ftoheni me ujë nga pozicioni i mbrojtur. Në rast të humbjes mos e spërkatni kontejnerin me ujë. Ftoheni zonën rreth e rrotull (nga pozicioni i mbrojtur) për të mbajtur zjarrin.
Mjete të mbrojtjes speciale	: Përdorni autorespiratorin në hapësirat e ngushta.

6 Masat në rast të rrjedhjes aksidentale

Masat mbrojtëse individuale	: Evakuoni zonën. Përdorni veshje mbrojtëse. Përdorni autorespiratorin për të hyrë në zonën e interesuar nëse nuk provohet që atmosfera është frymëmarrëse. Siguroni një ajrosje të përshtatshme.
Masat paraprake ambientale	: Tentoni të ndalni rrjedhjen. Evitoni futjen në kanalizime, bodrume, gërmime dhe zona ku akumulimi mund të jetë i rrezikshëm.
Metoda të shkarkimit të produktit	: Zonë e ajrosur.

7 Trajtimi dhe ruajtja


Të përgjithshme	: Tanket që përmbajnë ose që kanë të përfshira produkte të djegshme ose eksplozive nuk duhet të bëhen inerte me dioksidin e karbonit të lëngshëm. Përfshihet cdo formim i grimcave të ngurta të CO2. Sistemi duhet të mbështetet si duhet në tokë për të shmangur rreziqet e shkarkimit elektrostatik.
Trajtimi	: Evitoni thithjen e ujit në kontejner. Mos lejoni tërheqjen e gazit në kontejner. Përdorni vetëm aparatet specifike, të përshtatshme për produktin, presionin dhe temperaturën e përdorimit. Në rast dyshimesh kontaktoni furnizuesin e gazit. Ndiqni instruksionet e furnizuesit për trajtimin e kontejnerit.
Ruajtja	: Të ruhet kontejneri nën 50°C në zonë të ajrosur mirë.

8 Kontrolli i ekspozimit/mbrojtja individuale

Mbrojtja personale	: Siguroni një ajrosje të përshtatshme. Mbroni sytë, fytyrën dhe lëkurën nga spërkatja e lëngut.
Limitet e ekspozimit profesional	: Dioksid karboni (i ftohtë): ILV (EU) - 8 H - [mg/m ³]: 9000 Dioksid karboni (i ftohtë): ILV (EU) - 8 H - [ppm]: 5000 Dioksid karboni (i ftohtë): TLV [©] -TWA [ppm]: 5000 Dioksid karboni (i ftohtë): TLV [©] -TWA [ppm]: 5000 Dioksid karboni (i ftohtë): TLV [©] -STEL [ppm]: 30000 Dioksid karboni (i ftohtë): TLV [©] -STEL [ppm]: 30000

9 Veçoritë fizike e kimike

Gjendja fizike në 20°C	: Gaz.
Ngjyra	: Pa ngjyrë.

	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 4
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
Dioksid karboni (i ftohtë)		ALB-LCO2-018B

9 Vecoritë fizike e kimike / ...

Era	: Pa paralajmërim nga era.
Masa molekulare	: 44
Pika e shkrirjes [°C]	: -56.6
Pika e vlimit [°C]	: -78.5 (s)
Temperatura kritike [°C]	: 30
Tensioni i avullimit [20°C]	: 57.3 bar
Densiteti relativ, gaz (ajri=1)	: 1.52
Densiteti relativ, lëng (uji=1)	: 1.03
Tretshmëria në ujë [mg/l]	: 2000
Limitet e djegshmërisë [vol % në ajër]	: Jo i djegshëm.
Të dhëna të tjera	: Gaz/avull më i rëndë se ajri. Mund të akumulohet në hapësira të mbyllura vecanërisht në nivelin e tokës dhe nën tokë.

10 Stabiliteti e reaktiviteti

Produktet e rrezikshme të shpërbërjes	: Asnjë.
Stabiliteti kimik	: I qëndrueshëm në kushte normale.

11 Informacione toksikologjike

Informacione mbi toksicitetin	: Në përqëndrime të larta shkakton pamjaftueshmëri në frymëmarrje. Simptomat janë dhimbje koke, të përziera dhe të vjella që mund të çojnë në humbje të vetëdijës.
--------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

12 Informacione ekologjike

Informacione mbi efektet ekologjike	: Nëse shkarkohet në sasi të mëdha mund të favorizojë efektin serë. Mund të shkaktojë dëme në bimësi për shkak të ngrirjes.
Potencial për ngrohjen globale (: 1 GEP)	

13 Konsiderata në lidhje me tretjen

Të përgjithshme	: Mos shkarkoni aty ku akumulimi mund të jetë i rrezikshëm. Evitoni shkarkimin direkt në atmosferë të sasive të mëdha. Kontaktoni furnizuesin nëse mendohen të nevojshme instruksionet për përdorimin.
------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

14 Informacione mbi transportin


14.1. Numri ONU	: 2187
• Etiketa ADR, IMDG, IATA	



: 2.2 : Gaz jo i djegshëm jo toksik.

Transporti tokësor

ADR/RID

	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 5
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
Dioksid karboni (i ftohtë)		ALB-LCO2-018B

14 Informacione mbi transportin /...

- H.I. n° : 22
- 14.2. Emri i dërguesit të përshtatshëm : DIOKSID KARBONI LËNG I FTOHTË
ONU
- Klasa e rrezikut në lidhje me transportin : 2
- Kodi i klasifikimit ADR/RID : 3 A
- Instruksionet e paketimit – Të përgjithshme : P203
- Kufizimi i galerisë : C/E: Ndalohet kalimi në galeritë e kategorisë C dhe D për transportin në cisterna.
 Ndalohet kalimi në galeritë e kategorisë E.

Transporti detar

- Kodi IMO-IMDG
- Emërtimi për transportin : DIOKSID KARBONI LËNG I FTOHTË
 - Klasa : 2.2
- Grupi i paketimit IMO : P203
- Programi i emergjencës (EmS) - Zjarr : F-C
- Programi i emergjencës (EmS) - Firë : S-V
- Instruksionet - Paketimi : P203

Transporti ajror

- Kodi ICAO/IATA
- Emërtimi për transportin : DIOKSID KARBONI LËNG I FTOHTË
- Klasa : 2.2
 - IATA-aeroplan për pasagjerë dhe ngarkesa: E lejuar.

Evitoni transportin në mjetet ku zona e ngarkimit nuk është e ndarë nga kabina.

Siguroeni që drejtuesi është informuar për rrezikun e mundshëm të ngarkesës dhe di çfarë të bëjë në rast incidenti ose emergjence.

Para se të filloni transportin:


- Përcaktoni nëse ngarkesa është siguruar.
- Siguroeni që valvola e bombolës është mbyllur dhe nuk humbet.
- Siguroeni që tapa e valvolës është montuar në mënyrë korrekte.
- Siguroeni që kapaku është montuar në mënyrë korrekte.
- Me ajrosje të përshtatshme.
- Siguroeni zbatimin e dispozitave në fuqi.

15 Informacione mbi rregullimin

- 15.1. Normat e legjislacioni mbi shëndetin, sigurinë dhe ambientin specifik për substancën ose përzierjen : Siguroeni zbatimin e të gjitha rregulloreve kombëtare e rajonale.
- Rregullorja 96/82/EC : Nuk mbulohet. {EN}

16 Informacione të tjera

Në përqëndrime të larta mund të provokojë asfiksi. Të ruhet kontejneri në vend të ajrosur mirë. Mos thithni gazin. Kontakti me lëngun mund të shkaktojë djegie nga ngrirja. Rreziku i asfiksionit nënvlërohet shpesh dhe duhet të evidentohet mirë gjatë trajnimit të operatorit.

	SKEDA E TË DHËNAVE TË SIGURISË	Faqja : 6
		Varianti i marrë nr : 0
		Data : 16 / 1 / 2011
		Zëvendëson : 0 / 0 / 0
Dioksid karboni (i ftohtë)		ALB-LCO2-018B

16 Informacione të tjera /...

Kjo skedë e të dhënave të sigurisë është përpiluar në pajtim me direktivat europiane në fuqi dhe është e zbatueshme për të gjitha shtetet që kanë përkthyer direktivat në sfondin e legjislacionit të tyre kombëtar.

HEQJA DORË NGA PËRGJEGJËSIA

: Shoqëria nuk është përgjegjëse për dëmet e mundshme të provokuara nga përdorimi i produktit nga zbatimi jo korrekt dhe/ose në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara. Informacionet e përmbajtura në këtë dokument janë të vlefshme nga momenti i botimit. Para se të përdoret ky produkt në çfarëdo procesi ose eksperimenti, duhet të kryhet një studim i thellë mbi sigurinë dhe pajtueshmërinë e produktit me vetë materialet.

Fundi i dokumentit